

**Bashkim
Çepele**



Thirrja e tokës

BIBLIOTEKA
SHTETIT

85H-1

241

814-1
241

BASHKIM ÇEPELE

THIRRJA E TOKËS

poezi



11843

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

THIRRJA E TOKËS

Ka shumë kohë që më shqetëson thirrja e tokës,
Thirrja e diellit që thërrmohet mbi brazda,
Thirrja e kokrrës që ka plasur nën plis nga vlaga
Dhe, përmes dheut,
Zhvillohet,
Lëviz.

Më thërret toka.
Më thërret dashuria e stërgjyshërve dhe e babait,
Më thërret buka-rrënja e jetës
Dhe kënga e kooperativistëve në ugare.

Kam lindur në fshat dhe në fshat jam rritur
Me erën e baltës dhe të barit të kositur.
Nëna, kur korrte,
Më linte midis duajve,
Të luaja me kallinjtë.
Kallinj të rëndë
Mbjellur dhe korrur nga nëna.

Më thërret toka,
Duart e babait bojë gruri — të vrara nga plisi dhe
parmenda.

Më thërret toka,
Këngët e dyqind të rinjve të Hoxharës
Si valët e një deti të gjelbër të lashtash,
Si valët e arta të lulediellit në ara.
Kalojnë përmes meje
Dhe ma shtojnë mallin
Për pambukun, për grurin, për misrin, për barin.

Toka.
E gjitha sa shikojmë,
E jona është.
Si mund të ikim prej saj
Dhe ta lëmë mbrapa?...

Atje kanë mbetur,
Mes hapësirash dhe fushave,
Ëndrrat e mia më të bukura.

Atje ka mbetur, në sy të pellgjeve,
Fytyra ime
Me reflekse gruri,
E gjerë, e çelur

si një luledielli,

Më thërret toka, si nëna birin,
Që ka ikur e prej vitesh,
E ka lënë.
Dhe unë i përgjigjem — me mallin e birit:
«Po vij, nënë!»

PARTIA IME

Partia si nëna.

Në bebëzat e syve —

udha e fëmijëve,

Gëzimet dhe shqetësimet e tyre. . .

Në zemër të saj —

shkëndijë e stuhive.

Nëna ime,

Shqetësimi në qepalla i fërgëllon,

Fle

edhe s'fle.

Partia — zgjuar gjithmonë.

Ecën dhe ecim.

Në kokë helmetën e hekurt të revolucionit,

Në dorë flamurin e tij.

K R E D O

Gjithë jetën nëpër pozicione!
Përherë ushtarë dhe gjithmonë roje.

Gjithë jetën nëpër pozicione!
Nga thellësi e tyre vështroj një qiell me dritë.
I kam në trup, si dhjetëra medaljone,
Plagët e përgjakura që mora me armiqtë.

Gjithë jetën nëpër pozicione!
Mbrojmë gjakun tonë, këngët, të vërtetën.
Në gjumë s'do të na gjejnë kurrë,
Derisa të zhduket edhe armiku i vetëm.

Gjithë jetën nëpër pozicione!
Në qëndresë u thinjën dhe u rrudhën malet e
Shqipërisë.
Dhe midis fjalëve shkëlqen fjala: MBROJTJE!,
Që shtatviganë na ngre përballë historisë.

H O X H A R Ë, 1975

Këto vajza kanë ardhur nga qyteti
Në këtë vend që quhet Hoxharë,
Në këtë tokë që shterp e la deti,
Djegur nga kripa e bardhë.

Ato kishin të tjera profesione:
Kjo vajzë nitrat prodhonte në Azotik,
Kjo këtu, hekurin saldonte.
Tjetra në torno kish gdhendur çelik.

Dhe e donin të gjitha profesionin
Dhe për të flisnin me mburrje
Dhe udhët me neone i donir
Dhe sheshet plot njerëz dhe flamure.

Po Partia tha të ngrihet Hoxhara,
Mbi hektarët shterpë të zbardhte pambuku.
Udhët me neone ato i ndërruan me arat
Dhe profesionin me atë të bujkut.

Dhe mbiu fara e parë që ato hodhën,
Dhe po rritet gruri si një det i gjelbër,
Dhe rritet dashuria e tyre për tokën
Si rritet një flakë nga fryrja e erës.

DREJT JUSH

A do të arrij, vallë, deri te ju?
Jam nisur.
Hapin e parë po e hedh me këtë tufë vjershash
Dhe po çaj përmes shiut
e baltës
Rrugëve të kantiereve.

Kam me vete, në xhepin tim,
Urdhrin e luftimit,
Që koha më jep.
Dhe jam përherë në marshim.

Mes shtegut, të malit,
në Jonufër e në Fierzë,
Midis skelave e vinçave të Ballshit të ri
Më përshëndesin nxituar, me buzëqeshje
Shokët e mi të armëve
dhe të poezisë.

Duke vështruar relievin dhe horizontin
përreth

Bie në mendime:
A do të arrij, vallë, deri te ju?

KËNGË PËR DINO KALENJËN

Erdh në mbrëmje këshilltari
Dhe tha: «Mbahu, t'u vra djali!»

Doli nëna plakë në shkallë,
E heshtur me thinja në kokë.
«Dinoja nuk më është vrarë,
Dinoja po më vjen i gjallë
Me dyfek edhe me shokë!»

Dolën motrat varg në udhë
U përkulën, puthën plagët,
Puthën yllin edhe armët.

Doli vëllai hijerëndë
Si një shkëmb nga malet prerë
Dhe qëlloi me pushkë tri herë.

Dolën fshatarët të gjithë,
Duke bluar dhembjen ndër dhëmbë
E kënduan këngë.

BALADË PËR XHA DULEN

E kuptuam,
Më s'do e shihnim xha Dulen.
Për të fundit herë
Era lozte me mustaqet e bardha të tij
Dhe ai s'mund t'i shtronte me të praptë të dorës.
Xha Dulja ynë i mirë, me një shark të zi,
Që këndonte pas betejave me një zë të thellë,
Luftëtari i Çetës Plakë të Vlorës,
Që pati thyer
Tre mbretëri.

E kuptuam,
Tek shtimë batare
E ai s'u ngrit.

Na e vranë xha Dulen,
Po vinte pranvera dhe frynte era e jugës.
Nga kjo erë, thosh xha Dulja,
Çelin lule...
Dhe fërshëllente lehtë
Me cep të buzës.

KËNGA E ASIM ZENELIT

Një mijë herë e kam dëgjuar atë këngë
Dhe një mijë herë kam ndier brenda gjakut
Si fryhet Vjosa — det i gjerë me valë;
Dhe një mijë herë kam dëgjuar zërin e thellë
të tokës,

Qe pate jatak
Në netët partizane.
Fli i qetë o shok, se hakun do ta marrim! . . .

Fluturon përmes kohës kënga
Si një shqiponjë,
që çerdhen ka në gjakun tonë.

Ai ra në Grykën e Mezhgoranit
Dhe ngrihet më i gjallë në të tëra grykat,
Dhe lufton me shokët në të tëra pritrat,
Dhe ia merr këngës me zë kumbonjës.
Si ahere kur predhat digjnin në ara grurin e ri:
« . . dhe lufta vazhdon me furi!»

ËNDËRR FËMINIE

Unë nuk dija ç'ishin fashistët,
Isha fëmijë dhe kërkjoja bukë.
«Pusho, shpresë e nënës, s'e zbret gjarpri nga trarët»,
Më thosh gjyshja tek hidhte në vatër karthje.
Dhe hijet tona dridheshin në mur.
Jashtë bënte dimër, jashtë bora zbardhte,
Balashi donte kashtë,
muallinte në haur,
Por kisha uri dhe s'më zinte gjumi,
Në prehër të gjyshes qaja ngadalë,
E gjyshja murmuriste një këngë si përrallë:
«Ka dalë maleve babi me dyfek,
Ka dalë maleve xhaxhi me sëpatë,
Ta vrasin fashistin,
ta mbytin në gjak,
Pastaj do të vijnë nga malet e lartë.
Të bien bukë të bardhë, dhe arra, dhe mollë,
Do e puthin djalin në sy e në ballë,

T'i japin kalem, ta çojnë në shkollë...»
Heshtja dhe dëgjoja këngën e gjyshes
Në ëndërr shikoja se vinte babai.
Më puthte e më thosh: «Tonat janë të tëra
Dhe dielli dhe yjet dhe arat mbi lumë
Dhe lulet dhe zogjtë,
gruri dhe tërshëra...
Nga malet partizanët i prunë.»

THËRRESIN RRUGËT

(Shoferit Ethem Shpërdheja,
komunist pas vdekjes)

Thërresin rrugët të nisesh përsëri
Këtë agim,

kur unë shkruaj vjershë.

Të ngrihesh, të vraposh tutje, Jug-Veri,
Duke udhëtuar gjashtëmbëdhjetë orë rresht.

Të thërret nëna,

sytë i mbenë nga porta

Dhe ashtu në pritje diçka gatuan në vatër;
Mbase dy-tri petulla të buta, të ngrohta...
Sikur këtë mbrëmje ti do të vish patjetër.

Fëmijët i zu gjumi mbështetur te pritja.


Gjithë darkën na pyetën për ty.

Ardi rri menduar,

menduar rri dhe Lida:

«Mami, do të vijë babai?...»

«Do të vijë, xhan, do të vijë»



Si një kalë lufte Skoda rri menduar
Vështron me sytë e xhamtë dhe duket sikur thotë:
«Oh, në shumë beteja bashkë kishim shkuar
Dhe mund të shkonim në të tjera, plot!...»
Shokët lidhën krahët,
formuan me ta një vig
Dhe të ngritën lart, me dhembje në sy;

Partia hapi gjirin,
të bëri komunist...
Dhe rrugët, që të nisesh, thërresin përsëri.

DUART E BABAIT.

Mbi sofrabezin e bardhë duart e babait
Si dy bujashka të rënda (me kallo),
Thonjtë të nxirë nga goditjet,
lëkura me baltë dhe vaj
Lëvizin ngadalë, të sigurta
duart e babait.

Ja gishtat,
thyejnë mbi tryezë kafshatën,
Përdorin me mjeshtëri thikën, pirunin,
Gishti tregues, që shkrepri dikur nagantin,
Nipin përkëdhel me butësi në hundë.

Me këto duar janë përmbysur ugare,
Janë ujitur pjergulla dhe pjeshkë të buta
Përmes këtyre pëllëmbëve ka rrjedhur fara,
Që ka mbirë dhe është bërë bukë.

I vështroj këto duar ngjyrë gruri
Dhe ndjej përkëdheli,

si dikur...

NGA FËMINIA

Gjyshja tirrte lesh me drugë
Në atë shtëpinë tonë të vjetër.
Kërkëllinin qerret në rrugë,
Nata binte erë pjepër.

Gjyshja këndonte gjer afër mesnatës
Dhe drugën vërviste në duar,
Përkundej në të errët kurorë e akacies
Si re fantastike, e bardhë,
e kundërmuar.

Unë rrija i heshtur, as zgjuar, as në ëndërr
Dhe vështroja errësirën matanë.
E bukura e dheut dilte prej këngës,
Afrohej dhe më puthte në ballë.

Nga kopshtet vraponte veriu erë pjeshkë,
Yjet rrëzoheshin e digjeshin pa zhurmë
Udha e Qumështit ndrinte përmbi degë
Si një lëmë i gjerë me grurë.

FOSH NJES QË DO TË LINDE

Ne ende s'e kemi dëgjuar zërin e atij
Dhe zëri i tij shpesh na nxjerr gjumin.

S'ia kemi parë sytë, as ledhatuar flokët
Dhe ngado që shkojmë është midis nesh.

Ai na buzëqesh dhe doçkat i përplas
Kumbojnë horizontet nga gëzimi i tij.

Dhe ky gëzim, gëzimin tonë e shton,
Dhe ky gëzim e sjell më pranë majin.

LIRIKË PRANVERE

Me fyellin prej shelgu çobani i fshatit
Lajmëroi ardhjen e pranverës,
Këputi ndër proshka ca degë lofate
Në brirë ia vari mëshqerrës.

Rrëketë vezullonin nën rrezet e diellit
Tek rrëshqisnin mes barit të gjelbër,
Thoshe se ylberët qenë rrëzuar prej qiellit
Dhe tufa i pinte me etje.

MBI BREDHAT E OTOVËS

Ndonëse kemi udhëtuar gjashtëmbëdhjetë orë radhë
E jemi ngjitur një mijë e gjashtëqind metra lart,
S'më zë gjumi as mua, as ushtaren Bardhë,
As komisarin e urtë Fuat.

Përgjojmë heshtjen të shtrirë nën degë e gjethe,
Mbi bredhat e Otovës, hëna lart po ngrihet.
Kanë çelur plot yje të kuq, si lule shege,
Dhe çuditërisht
s'na flihet.

LISI I BANIT

300 vjet më parë vllahu Bani
Hoqi gunën,

të mbolli filiz.

Si mund të mendonte që sot unë,
ushtari,

Të kam orientuesin më të mirë.

Nën degët e tua janë çlodhur delet,

Janë shtrirë udhëtarët

Kanë fjetur e kanë shkuar.

Tani çdo mëngjes

Topat e rëndë rrotullojnë ushtarët
të mjegulluar.

Ne ushtarët të kemi shokun tonë,

Një shok të largët, të vjetër

Dhe jemi mësuar të të vështrojmë në horizont

Si një roje

përballë botës tjetër.

E po të vij koha,

edhe për ty

Do dimë të vdesim, lisi i Banit.

GRUSHT

Të pesë gishtat e mi të dorës
Të mbledhur grusht,
Pesëdhjetë herë më e fuqishme
Dora ime.
Shqiptarët — një grusht
Dy milion gishtërinjsh,
Dy milionë punëtorë me armë dhe pajime.

Kështu kemi çarë përmes kohës.
Rrugën tonë,
 si një të prerë shpatë,
Në shekuj kemi gdhendur
 me shpatë e plumba...

Goditjet e saj na kanë mprehur syrin,
Na kanë zgjeruar gjoksin,
Na kanë rritur forcën dhe peshën e krahëve
Dhe kemi ecur më tutje me pushkë e me plumba
Në rreshta të gjatë ushtarësh.

Ç A N G A

Mbrëmë,
Nën vërshëllima sirenash nxitonin makinat,
Që mbartnin mbi shpinë punëtorë të armatosur.
Të tjerët, rezerva,
vraponin në uzina.

Aeroplanët fluturonin pjerrët mbi çati.
(Qetësi, shokë, futuni në rreshta!)
Tanket shkelnin rëndë ndanë të mbjellave,
vreshtave
Dhe ne vraponim në postën tonë,
në bateri.

Një çangë e rëndë. Çang! Çang! Çang!...
Trokëllinte në degën e një rrapi,
në fshat.

Batalionet thërriste në alarm,
i inkuadronte në rreshta të gjatë.

(I zumë të gjitha urat, kodrat, stacionet,
Tytë e pushkës luhatej në terr.)
Çang! Çang! Çang! . . .
Në mbrojtje sulet tërë një armatë,
Sa dëgjonte këtë çangë të thjeshtë alarmi.

ENDËSET E SIXHADEVE

Milimetër pas milimetri
Konfiguracioni i ëndrrave të holla
Merr formë
Në argatin e trashë.

Ato s'janë vetëm ëndrrat tuaja, moj vajza,
Ato janë edhe ëndrrat e nënave tuaja,
Ato janë edhe ëndrrat e gjysheve tuaja,
Ëndrrat e vrara,
Gonxhet e palulëzuara
Nga pranvera e ditëve tona
Të ringjallura.

Milimetër pas milimetri
Gjithë ngjyrat e spektrit
Nëpër gishtat tuaj
Derdhen,
 lidhen nyje.
Ëndrrat e holla,

Pa pluhur dhe hije
Shkrihen marrin forma.

Nëpër gishtat tuaj
Jo fije me ngjyra,
Jo argaç i bardhë,
Po ylberë e yje
Derdhen edhe ndrijnë.

PËR DITËT E DIELA

Të dielat e mia digjen në bregdet,
Hidhen përmbi valë, bëjnë banja dielli,
Pinë aranxhata.

Të dielat e tua venë në ekskursion,
Freskohen në hije, mbllaçitin sallam,
Pinë birra në park.

Të dielat e nënës ndehen nëpër tela;
Çarçafët e bardhë djersën ia përthajnë.
Ulet e këputur dhe mbështet kokën
Mbi këmishët tona.

Një propozim kam:
Më drejtë t'i ndajmë këto ditë të diela.

KOOPERATIVISTËT

Qielli në shi,
Vjeshta mbarsur me mbjelljet,
Ju vini nga arat dhe shkoni në ara,
Duke çarë përmes
Ugaret, plisat dhe brazdat.

Kështu do të veni e do vini përherë —
Herë përmes baltrave
E herë përmes prillit:

... Gjurmët e këmbëve tuaja

det i gjelbërimit.

KOOPERATIVISTIT QË REALIZOI 1047 DITË
NË NJË VIT.

Ti nuk shpërtheve nga vëllimet e ciklit të
kreshnikëve,
Me bujë nuk dole në mejdan për luftë;
S'të pollën gojëdhënat e bjeshkëve epike,
Po toka e ashpër, fjala e bardhë-bukë.

Kështu ndodhi që prishe kalendarët
1047 ditë pune arrite në një vit,
Duke vjelur nga toka ëndrrën stërgjyshore,
Fjalën «rehat» duke thërrmuar si plis.

Me të dhjetë vargjet, si me dhjetë gishta
Dorën tënde shtrëngoj fort, shok!

AJO NATË...

Ajo natë mbi ujëra,
Mjegulla e rëndë që shtrihet mbi lumë,
si një tendë gri,
Hijet e çifteve mes hijeve të drurëve,
mes shushurimës së degëve dhe valëve;
Ziarret dhe kasollet me kashtë të peshkatarëve,
Kënga e tyre me mallin për gratë,
me ëndrrat e bardha që tjerrin
Dallgë kundërmimi të ëmbël, të padukshëm, ajror.
Rrjedhin e
Rriedhin...

MINA MARINI

Atje midis arave të kooperativës «Agimi»
Punon kooperativisti Mina Marini.

Kthehet në mbrëmje me pak baltë në rroba
Me fushën, me lumin dhe diellin në ndërgjegje
Dhe shkruan për shokët vjersha të ngrohta
Duke e flakur lodhjen.

Mbi bllokun e vjershave shpesh e zë gjumi
Dhe i përzihen ëndrrat vargjet dhe gruri.

Ë N D Ë R R

Eridanën dhe lodrat tani i zuri gjumi
Dhe një ëndërr e bukur ato i përkund.
Te porta e ëndrrës, ushtari prej plumbi,
Bën roje me pushkë.

Kukulla leshverdhë me sy të kaltër
E lidhi mbi flokë shaminë
Dhe me mamin iku tek ara
Të mbledhin lule, kallinj.

Qukapiku dhe ketri i shkathët
Kanë hipur mbi pemë dhe lozin nëpër degë;
Dhe shportën e vogël ia mbushin Eridanës
Me kokrra të buta, me mollë dhe me shegë.

Pastaj u ulën në sheshin plot bar,
Nën diellin e kuq që varej si balonë
Dhe erdhi ariu i vogël fotograf
E, «praf», bëri një pozë dhe shkoi.

Eridana lëviz dhe qesh nëpër gjumë
Edhe thotë: — «Do të vi edhe unë»...
Te porta e ëndrrës, ushtari prej plumbi
Bën roje me pushkë!

FUND MARS I

Pranvera erdhi përmes shirave me diell të marsit
Dhe pushtoi tërë fushën.

Rrjedhin currilë rrëketë dhe vezullojnë
si ylber mes për mes saj.

Pemët e sapolulëzuara zbardhin,
Tunden,

Sikur vallëzojnë ndanë udhëzave dhe kopshteve,
Skaj më skaj.

PEISAZH PRILLI

Qerpikët e gjelbër të barit

Çelën edhe panë prillin,

Pika vese u derdhën mbi qerpikë

Si miliona margaritarë

të dridhshëm.

Më zgjoi herët një shqetësim i ëmbël,

Trokiti një zog në xham

edhe iku,

Vrapova jashtë,

mes zhabinës së dendur;

Mes tërfilit të butë si akriliku.

Ky mëngjes ishte i tëri imi

Dhe isha më i lumturi në planet.

Qëndroja buzë pranverës,

kur shpërthen gjelbërimi

Si bujk

dhe si poet.

Në qerpikët e hollë të barit,
Në puplat e sythave, burbuqeve
Hynte dielli me faqet prej zjarri,
Hynte dielli dhe... shkërmoqej.

Nga përçafimi i tyre çelin gonxhe
Dhe fruta rriten, të ëmbël,
Vërshëllejnë kosat nëpër jonxhë
Fiu... fiu... si fëmijë nëpër lëme.

U KORR GRURI....

U korr gruri, lidhen duaj...
Kombajnerët grurë përtypin
Si të përtypnin këngë grunajash,
Si të përtypnin copëra dielli,
Kashtoret hedhin mbi supe.

Përmes fushës duket, zhduket
Kurmi yt kalli i plotë,
Mbi qepalla ca hala gruri,
Hala gruri nëpër flokë.
Shtati yt me grurë përzier.

T'u poq buza ëndrrash puthur,
Duke bredhur arë më arë.
Do të vrapoj në bostanet
Të marr shalqi,
të hash një thelë
Ulur shesh përbri kombajnës.

Përtej fushës, në horizont
Perëndimi ndezi qiellin,
Dielli varet si balonë...
Zëri yt tallaz kumbon
Arë më arë, ku korret grurë.

Ç A S T

Në thellësi të tunelit —
si në thellësi të mendimit
Ulemi mbi shkëmbinj dhe rrimë
Dhe ndezim cigaret në flakë të fencerit
Dhe ndërrojmë barominat.

Gurë të dërrmuar na bien mbi helmata,
Vetullat nga pluhuri
të rënduara.
Thith cigaren i etur Mete Mema,
Minatori ynë nga Mashkullora.

Dhe këndon me një zë të bukur
Për pushkë dhe plagë në prita,
Për një grua plakë, të rrudhur,
Për një varr të vetmuar te brinja...

Kjo është këngë e lashtë si erërat
Dhe Metja e këndon me dhembje;
Në thellësi të tunelit

shpërthen

Isoja labe, si gjëmimet.

Në zemër të malit,

të lagët, të egër

Ulemi mbi shkëmbinj e rrimë,

Shtiemë edhe ca karbit në bark të fenerit

Dhe mprehim barominat.

TE DRITARJA GJËMON DETI...

Te dritarja ime po gjëmon deti,
Brigjet plot shkëmbinj me valë e shkum rreh.
Këndojnë Vunoi, Dhërmiu, Piqerasi
Të famshmen këngë malli:
«Vajzë e valëve»

Te dritarja ime po gjëmon deti.
Mua në ëndërr më duket çdo natë,
Sikur kthehen burrat nga kurbeti,
Çohem me një frymë, kanatet hap.

Askush nuk ka ardhur... askush nuk troket
Nën dritën e hënës deti zbardh dhe nxin.
Nga gjëmimi i dallgës plasi zemra ime
Si guackë e detit hedhur në stere.

Brigjet e Himarës pikojnë mall e dhembje:
«Vajzë e valëve».

LIGJËRO, BILBILI YNË...

Rastisi të flemë sonte në mes të fushës
Nën qiellin e thellë me yje,
mbi erën dehëse të barit të kositur.

Flinim përkrah lulediellit,
përkrah flladit që luante me kokat e tyre
si krifë luani.
Dhe gjithë drita e diejve na regëtinte dhe na digjej
në sy.

Fshati s'dukej ku ishte,
po ndihej prania e tij;
Dy vajza (mbase dy mjelëse të fermës),
që në agim

Këndonin: «Ligjëro, bilbili ynë»...
Dhe mëngjesi zbriste i bardhë, i freskët
Dhe ajri kundërmonte sikur rridhte nga gjiri i
pjeshkëve.

KJO NATË QË SHKOI

Mbrëmë, i dashur, të kam pritur vonë.
Thëngjijtë e fundit u shuan në stufë
Dhe gjella u ftoh
Po ti nuk më erdhe.

Pse vallë?

Ndoshta ishe larg, nëpër shpate malesh,
Ndoshta pozicionet thelloje në terr.
(Apo hendeklidhjet, si zigzag rrufeje.)
Nuk e di.
Një plep me erën fliste, mu pranë dritares,
Dhe më dukej se pranë dritares ti vije e veje.

Veje e vije te dritarja jonë
Dhe derën s'e hapje
Të futeshe brenda.
I dashur, mbrëmë të kam pritur vonë,
T'i ndieja te pragu këpucët e rënda.

Këpucët e tua gjithë baltë prej ushtari,
Pelerina e lagur
E ti, i lodhur dhe i qeshur prapë...
E prapë i përmallur.

PO IKI

Po iki.

Mirupafshim, Durrës.

Të pesëmbëdhjetë ditët e kampit me detin dhe diellin

I marr me vete në fytyrë e trup.

Hedh sytë nga bregu.

E ndiej,

këtu diçka nga unë mbeti.

Një këngë,

Një varg, disa figura përzier me rërë dhe kripë,

Silueta ime që do endet në mugëtirë,

pranë monologut të erës,

Pranë silueta pishash, pranë silueta vajzash të bukura

me vështrim të butë përkëdhelës.

Po iki.

Busti i Qemalit, shezlongu i invalidit, gëzimi kumbonjës

i pishave dhe dallgëve,

Ai veterani i luftërave me një copë predhë mes brinjëve,

Nëna e tij e zbardhur si një perçe dallge,

I nipi,

Kënga e atyre të treve te bregu,

në muzg, vonë:

«O Enver Gjirokastriti...»

Iki dhe marr me vete këtë bagazh kujtimesh.

TI ERDHE

Kam pritur kaq shumë
Duke dëgjuar çobanin me një fyell shelgu
E në atë fyell-Myzeqenë e butë me qumësht
e grurë.

Duke parë diellin si ngjitej mbi-male,
Si zbriste drejt detit, pastaj, në muzg,
Si lahej lakuriq në mes të dallgëve.

Kam pritur e kam pritur kaq shumë
Me vizionin tënd të dridhshëm në sy,
Duke djersitur marshimeve,
Duke u flladitur anë deteve
U kam vjedhur qetësinë — për ty
Netve.

Dhe ja ku erdhe,
Më e pastër nga vetë emri yt i bardhë,
Më e thjeshtë se vetë thjeshtësia,

Më e bukur se në ëndrrat e mia,
Midis të gjitha dashurive —
Dashuria ime e parë.

Si një diell mbi grunjëra
Re mbi blerimin e shpirtit.
Në mrekullinë e thellë të syve
Lëkundej
Imazhi i ditëve që vinin.

ROMANTIKE

Netët e qershorit
Dehur nga aroma
Varen mbi lëmenj
Si degë të njoma.

Shtrihen nëpër duaj
Digjen mbi qershitë,
Yjet ujë të freskët
Pinë në koritë.

Hëna dritë derdh
Mbi fshatrat, bostanet,
Varur nëpër degë
Si një pjeshkë e madhe.

DRIDHEN DHE KUMBOJNË...

Dridhen dhe kumbojnë korijet me pjergulla,
Sikur parandjejnë shirat që po vijnë.
Fshatarët hypin mbi shelgjet, mbi plepat,
Këpusin veshulë dhe mbushin kofinë.

Dhe duke mbartur që nga ara frutat,
Duke zier kazanin për të nxjerrë rakinë,
Nën shirat e parë parandjejnë çupat
Dasmat që vijnë... Dasmat që vijnë.

KUR TI KËNDOJE

Kur ti këndoje,
Fryu erë e detit përmes gjetheve të dafinës
E qenien time përshkroi tejpertej,
Përkuleshin misrat nën peshën e kallinjve,
Lulediellit luhateshin, shtyheshin,
Sikur me ty donin të dilnin në skenë.

Ktheheshin nga kullotat tufat me dele,
Ktheheshin bareshat dhe barinj të
dhe tufat me lopë,
Godiste tallazi brigjet e Semanit,
Mua gjaku më vërshonte nër aortë.

Kur ti këndoje,
Në këngën tënde u mblodhën dhe kënduan
gjithë shoqet e brigadës,

U mblodhën bareshat dhe barinjtë
Dhe tufat me dele.
Vendlindja jote e gjelbër shtrihej e shtrihej...
Vendlindja jote
si kënga më e bukur,
Çelte.